



Protokoli i shkurtë i mbledhjes së Kuvendit të tetë të rregullt të BISHZ-së më 19.11.2005

Vendi: Adresa: Formazione (Salla Cavalieri), Freiburgstr. 139c, 3008 Bern.
Data: E shtunë, 19 nëntor 2005 / 17.00-19.30
Protokoli: Abas Fejzullahi (sekretar)
Pjesëmarrës: Rreth 35

Pikat e rendit të ditës

Programi

Pjesa e parë: Kuvendi i tetë i rregullt

1. 17:00 Hapja e Kuvendit (**Inxh. i dipl. Sinollah Shehu, nënkryetar**)
2. 17:10 Fjala hyrëse dhe vështrim i shkurtë i punës tetëvjeçare të BISHZ-së (**Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar**)
3. 17:20 Paraqitja e raportit të punës së BISHZ-së për periudhën 19.11.2004 - 18.11.2005 (**Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar**)
17:40 Diskutim i hapur
4. 18:00 Zgjedhja e Kryesisë së re dhe Komisionit të kontroll-revizionit
18:10 a) Zgjedhja e Kryesisë së re sipas nenit 5c të Statutit (**Të gjithë**)
18:10 b) Zgjedhja e Komisionit të kontroll-revizionit sipas nenit 5d të Statutit (**Të gjithë**)
5. 18:00 Ndarja e mirënjohjeve (**Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar**)
6. 18:10 Të ndryshme (**Të gjithë**)
18:20 Mbyllja e Kuvendit

Pjesa e dytë: Promovimi i librit "Makinat Elektrike Komplementare" i autorit Dr. Sc. Rifat Gjota

- 18:30 Fjala Hyrëse (**Inxh. i dipl. Sinollah Shehu, nënkryetar**)
- 18:35 Paraqitje e shkurtër e jetëshkrimit të Dr. Sc. Rifat Gjota (**Dr. Sc. Ahmet Xhigoli**)
- 18:45 Paraqitja e disa rezultateve të përshkuara në libër (**Dr. Sc. Rifat Gjota**)
- 19:15 Diskutime
- 19:30 Mbyllja e promovimit



Pjesa e parë: Kuvendi (17:00 – 18:20)

1. Përshëndetja e të pranishmëve – hapja e Kuvendit

Sipas programit të parapar inxh. i dipl. Sinollah Shehu, nënkryetar, bëri hapjen e Kuvendit të VIII të rregullt dhe i përshëndeti të gjithë të pranishmit e në veçanti pjesëmarrjen e **Dr. Sc. Rifat Gjota** në këtë Kuvend.

2. Fjala hyrëse dhe vështrimi i shkurtër i punës tetëvjeçare të BISHZ-së

Në këtë pikë, dr. sc. Ahmet Xhigoli, kryetar, i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi ata për pjesëmarrje në Kuvendin e VIII-të të Bashkimit të intelektualëve shqiptarë në Zvicër me seli në Bernë dhe paraqiti një vështrim të punës tetëvjeçare të Shoqatës.

3. Paraqitja e raportit të punës së BISHZ-së për periudhën 19.11.2004 - 18.11.2005 (Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar)

Dokumenti "Raporti vjetor nr. 8 të i BISHZ-së prej 19.11.2004 - 18.11.2005 u është shpërndarë të pranishmëve duke u përkujtuar se pas leximit nga të nteresuariat pranojmi vërejtjet dhe plotësimet e arsyetuara te cilat do të miratohen nga Kryesia me miratimin e Raportit.

4. Zgjedhja e Kryesisë së re dhe Komisionit të kontroll-revizionit

Z. Sinollah Shehu, dha shpjegimet e nevojshme lidhur me Zgjidhjen e Kryesisë së re dhe propozimet e Kryesisë nga mbledhja paraprake ku kërkohet nga anëtarët qe Kryesia ta vazhdoi edhe një mandat, me arsyetimin qe ne mandatin e ardhshem te udhëheqin anëtarët e rinjë dhe u theksua se kjo kerkesë ishte nga antarët e rinjë me qëllim të fitoj përvojë brenda këtyre dy vitesh.

Nga Kryetari u dha sqarimi se poashtu nga mbledhja e kaluar është bërë propozimi qe mandati i kryesisë së ardhme te jet 4 vite dhe jo si deri me tani dy vite. Kërkojmi nga Kuvendi t-anëtarët qe te diskutohet dhe miratohet me vota ndryshimi i kohzgjatjes se propozuar apo te mbetet siç ka qenë.?

Z.Xhevat Salihu ne diskutimin e tij mes tjerash ishte qe 4 vite është shumë por 3 vite mjafton. Ndersa Skënder Jusufi ishte për çdo dy vite.

Sekretari Abas Fejzullahi dha sqarime se per këtë duhet bërë ndrimi i pikës në Statut ku bëhet fjalë për kohëzgjatjen e Kryesisë, nese miratohet ky ndryshim qe kërkohet qe sa kohë nga propozimet e anëtarëve te Kryesisë dhe se e kemi lënë që tani në Kuvend te vendoset.

Pasi u diskutuar lidhur me kohëzgjatjen e Kryesisë së ardhme te jet 4 vite arsyetimin per këtë e dha Z. Resmije Berisha-Balaj dhe nga Besim Gerxhaliu. Me shumicën e votave u mirata kohëzgjatja prej dy në katër vite per Kryesin e Ardhshme. Poashtu u vazhdua edhe per dy vite e njeita Kryesi. Nga propozimet për Këshillëtar dhe administrator s'pat vërejtje dhe u pranuan si këshilltar të rinjë Z. Fatmir Bajrami dhe Gani Balaj në drejtimin për çështje ekonomike dhe sociale.

Zgjedhja e Kryesisë së re sipas nenit 5c të Statutit:

U mirata nga Kuvendi vazhdimi edhe për dy vite i Kryesisë së deritashme: **Dr. Ahmet Xhigoli, kryetar, Sinollah Shehu, nënkryetar dhe Abas Fejzullahi, sekretar.**



Propozimi i emrave për këshillëtar dhe miratimi i tyre në Kuvendin e tetë më 19.11.2005		
Nr.	Emri dhe mbiemri i këshillëtarit-es-administratorit	Seksioni
01	Agim erbavci	Sport
02	Adnan Mehmeti	Teknik-Informatikë
03	Besim Gërxfhaliu	Përkthime
04	Fatmir Shabanaj	Ekonomi
05	Florije Rexhaj	Për çështje sociale dhe integrim
06	Florim Thaqi	Shëndetsi
07	Xhevat Salihu	Shëndetsi
08	Gani Balaj	Për çështje sociale dhe integrim
09	Resmije Berisha	Arsimit
10	Venera Gërxfhaliu	Përkthime
11	Llokman Beqiri	Administrator
12	Shkumbin Rrmoku	Administrator

Zgjedhja e Komisionit të kontroll-revizionit sipas nenit 5d të Statutit:

Propozimi për zgjedhjen e komisionit të kontroll-revizionit prej tre anëtarëve. Ishte të jetë: **Adnan Mehmet** , **Ismet Rexhaj** dhe **Llokman Beqiri**. Propozimi u miratua njëzërit.

5. Ndarja e mirënjohjeve

Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar njoftoi të pranishmit me traditen e BISHZ-së lidhur me ndarjen e mirënjohjeve për anëtarët e saj lidhur me punën dhe angazhimin e treguar për mbarvajtjen e veprimtarisë së Shoqatës dhe mirënjohjet të cilat i ndanë për veprimtarët e veçantë në fusha të ndryshme të Kulturës,artit dhe shkencës dhe veprimtarëve të dalluar për çështje kombëtare nga të gjitha trojet Etnike .

Propozimet që bëhen për mirënjohje nga anëtarët e Kryesisë jipen sqarime dhe fakte lidhur me propozimin e bërë dhe në bazë të argumenteve dhe dëshmime të veprimtarisë u ndahet edhe mirënjohja.

Në këtë Kuvend do do t'ju ndahen mirënjohje veprimtarëve të dalluar në fusha të ndryshme nga Shkenca, Arsimit dhe Kultura dhe veprimtaria për çështje kombëtare kryesisht jashta shoqates sonë duke theksuar se mirënjohje ndahen edhe Zvicëranëve dhe Zvicëranëve siç kemi rastin me Zotëri **Fritz Aerni** dhe **Z. Antonia Aerni** të cilët erdhen me vonesë por, janë në mesin tonë dhe ne shfrytzojmë rastin dhe ti përshtesim për zemërsisht për pjesëmarrje në Kuvendin tonë.

Me Rastin e ndarjes së mirënjohjeve lexonte përmbajtjen secilës mirënjohje .Me rastin endarjës së mirënjohjes për **Z. Fritz Aerni** ja dha fjalën pasi kërkoi i cili foli nja 45 minuta lidhur me librin e tij dhe padrejtsinë në instancat gjyqësore në Kantonin e Aargau- t lidhur me të huajt dhe ne rastin konkret me Jeton Kabashin nga F.Korishë e Prizrenit Kosovë dhe paragjykimet...që sipas mendimit dhe bindjeve të tija të cilat dhe i ka publikuar në librin e botuar në gjuhën Gjermane lidhur me drejtësinë në peshojë në librin:**Gestehen Sie endlich !** Polizei und Justiz in der Kritik dhe vepra tjera psikologjike..! e etj...

Ndërsa me rastin e ndarjes së mirënjohjes shkenctarit të mirënjohur nga Kosova Zotëri Rifat Gjota, dha një propozim që të jet edhe Anëtar nderi i Shoqates sonë, duke pyetur njëherit edhe zotriun se a pranon një propozim që u bë nga Kryetari **Z. Ahmet Xhigoli**.

Z. Rifat Gjota i emocionuar u falënderua shumë për këtë befasi dhe pranoi tha me gjithë dëshirë prpozimin tuaj dhe ky është një nderë i madh për mua dhe i dyfisht sot: Sepse mu dha mundësia ta bëjë promovimin e Librit tim dhe befasia tjetër të jem anëtar nderi në Shoqaten BISHZ-së, për mua është nderë dhe kënaqësi e veçantë, andaj i dëshiroi gjitha të mirat Shoqatës BISHZ-së..tha mes tjerash **Dr.Rifat Gjota** në diskutimin e tij

**Ndarja e Mirënjohjeve në Kuvendin e tetë të BISHZ-së, më 19.11.2005**

Nr.	Emri dhe mbiemri	Drejtimi i veprimtarisë	Propozuar dhe arsyetuar nga :
1.	Dr. Sc. Rifat Gjota, nga Peja, prof. në Universitein e Kosovës	Për kontributin e dhënë në zbulimin shkencor: "Makinat Elektrike Komplementare-Komplekse"	Dr. Sc. Ahmet Xhigoli, kryetar i BISHZ-së
2.	Tahir Z. Berisha, profesor në pension dhe publicist nga Gjilani Kosovë	Për kontribut të veçantë për Arsimin Kombëtar	Abas Fejzullahi, sekretar i BISHZ-së
3.	Mehmet Xhevor, veteran i Arsimit Kombëtar-Prishtinë -Kosovë	Për kontributin e veçantë në zhvillimin e Arsimit Kombëtar	Resmije dhe Gani Balaj këshilltarë të BISHZ-së
4.	Mersim Oupi, nga fshati Cervicë Kërçovë	Për kontributin e veçantë për çështje kombëtare	Abas Fejzullahi, sekretar i BISHZ-së
5.	Fritz Aerni, Psikolog & Publicist nga Zürich- Zvicër	Për kontributin dhënë drejtësisë për Lirin dhe të drejtat e njeriut	Ahmet Xhigoli, Abas Fejzullahi, dhe Resmije Balaj anëtarë të Kryesisë së BISHZ-së
6.	Antonia Aerni Publicist nga Zürich- Zvicër	Si mbështetje dhe pionere për Lirin dhe të drejtat e njeriut	BISHZ-së
7.	Reshit Morina, Gerlafingen /SO	Refer i sportit ne Gerlafingen	A.Xhigoli & B.Gerxhaliu
8.	Halim Spahija, Gerlafingen /SO	Refer i sportit ne Gerlafingen	A.Xhigoli & B.Gerxhaliu

5. Të ndryshme

Në këtë pikë të rendit të ditës, nuk pati diçka konkrete.

Pas përfundimit të kësaj pike, zotëri Sinollah Shehu shpalli të mbyllur Kuvendin, dhe i njoftoi të pranishmit për një pushim prej 10 minutash.

Mbledhja e Kuvendit përfundoi në ora 18:20.

Pjesa e dytë: Promovimi i librit "Makinat Elektrike Komplementare" i autorit Dr. Sc. Rifat Gjota

Fjala Hyrëse (Inxh. i dipl. Sinollah Shehu, nënkryetar) njoftoi të pranishmit se sot do bëhet Promovimi i librit "Makinat Elektrike Komplementare-Komplekse" i autorit Dr. Sc. Rifat Gjota dhe njoftoi të pranishmit se lidhur me jetëshkrimin e tij do të na njoftoi Z. Ahmet Xhigoli ma gjërsisht.

Paraqitje e shkurtër e jetëshkrimit të Dr. Sc. Rifat Gjota (Dr. Sc. Ahmet Xhigoli)

Dr. Sc. Ahmet Xhigoli lexoi jetëshkrimin e përgatitur për **Dr. Sc. Rifat Gjota** dhe në mënyrë profesionale e të thukt njoftoi lidhur me të arrijurat dhe veprimtarin shkencore në fushen e teknikës, sidomos rreth elektromotorave etj.

Paraqitja e disa rezultateve të përshkruara në libër (Dr. Sc. Rifat Gjota) "Makinat Elektrike Komplementare"

Në kohën e parapar prej 30 minutash në mënyrë profesionale dhe përmes vizatimeve e projekteve bëri shpjegimin lidhur me rezultatet e punës së tij kërkimoro shkencore disaveçare në fushen e Makinave Elektrike Komplementare dhe rezultatet e arritur në kushte dhe rrethana specifike si dhe pamundësia e jetsimit praktik në Kosovë për shkaqe të mjeteve linciare dhe rrethanave të ma parshme nën okupimin e Serbisë...!



Diskutimet:

Nga të pranishmit pati pyetje profesionale dhe nga professori u dhan poashtu përgjegje lidhur me pyetjet e parashtruara. Në këtë drejtim shpjegime lidhur me disa njohuri teknike shkurtimisht dha shpjegime edhe Dr. Ahmet Xhigoli.

Në ora 19.30 përfunduan diskutimet lidhur me promovimin e librit dhe u bë thirrje të pranishmëve për darkën e përbashkët pas përfundimit të Kuvendit të VIII-të të BISHZ-së.

Pjesa e tretë: Darka e përbashkët me anëtarët e BISHZ-së, familjarët e tyre dhe mysafirët e ftuar.

Në përgjithësi kaloi mirë dhe kështu përfundoi programi i parapar.

*Udhëheqës i protokolit: Abas Fejzullahi
Solothurn, 11 shkurt 2006*